



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



**UDHËZUES PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
UDHËZUESIT PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NË KOSOVË, DHE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR
ME DATË 13 QERSHOR 2018, SI DHE I NDRYSHUAR DHE I
PLOTËSUAR ME DATË 30 TETOR 2018**

Prishtinë, 28 mars 2019



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafin 1, nënparagrafin 1.7, Nenin 25, Neni 26, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05-L-084), në seancën e mbajtur me datë 28 mars 2019 miratoi:

UDHËZUESIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZUESIT PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të datës 18 janar 2017, dhe plotësim ndryshimet të datës 13 qershor 2018, si dhe plotësim ndryshimet e datës 30 tetor 2018 të miratuara nga Bordi i Rregullatorit.

Neni 2 Derregullimi i çmimit për konsumatorët fundor

Neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin në vijim:

- 1.3.1 *Konsumatorët komercial në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët i nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020;*
- 1.3.2 *Konsumatorët komercial në nivelin e tensionit 10 kV, të cilët i nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2021;*

Neni 3 Dispozitat kalimtare

Dispozitat tjera të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike të datës 17 janar 2017 dhe plotësim ndryshimet të datës 13 qershor 2018, si dhe plotësim ndryshimet të datës 30 tetor 2018 të miratuara nga Bordi i Rregullatorit, mbeten të pandryshuara dhe do të zbatohen në tërësi.

Neni 4 Plotësimi i kushteve teknike

Rregullatori do të ndërmarr veprime konkrete ligjore për plotësimin e kushteve teknike dhe ligjore që ndërlidhet me çështjet e përshkruara në udhëzuesin për liberalizimin e tregut.



Neni 5 Ndryshimi

1. Rregullatori ka të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj dispozitat e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut do të jenë të njëjta si për miratimin e tij.


Neni 6 Interpretimi


Në rast se ka paqartësi për dispozitat e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut, Bordi do të nxjerr informacione shpjeguese.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Plotësim ndryshimet e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRR-së.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar